



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 16.02.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Etem Arifi dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Jasmina Zhivković, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paçaku.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinatori i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Edona Tolaj-YIHR, Selvete Gerxhaliu-GDNJD, Lejla Selimi-OSBE, Agim Sulaj-Lajmi net, Agon Foniqi-Kosova Press dhe Visar Bivolaku-EUO/EUSR.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Formimi i Panelit rekrutues dhe emërimi i kryesuesit të Panelit për rekrutimin e kandidatëve për Avokat të Popullit;
3. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Formimi i Panelit rekrutues dhe emërimi i kryesuesit të Panelit për rekrutimin e kandidatëve për Avokat të Popullit

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit se konkursi për Avokatë të Popullit është mbyllur dhe tani duhet të bëhet formimi i Panelit rekrutues për intervistim të kandidatëve, në pajtim me ligjin për Avokat të Popullit dhe rregullores. Paneli duhet të ketë përbërjen nga të gjitha partitë e përfaqësuara në komision, ato parti që janë të përfaqësuara me nga dy anëtarë në komision përfaqësohen me nga një anëtarë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, duke u bazuar në nenin 3 të Rregullores për Zgjedhjen dhe Shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të Zëvendësve të Avokatit të Popullit Nr. 04-V-049, në mbledhjen e mbajtur më 16 shkurt 2015, miratoi këtë

V e n d i m

1. Formohet Paneli rekrutues dhe emërohet kryesuesi i Panelit për rekrutimin e kandidatëve për Avokat të Popullit, me këtë përbërje:

- Lirije Kajtazi (G- LDK) kryesuese e Panelit,
- Salihe Mustafa (G-PDK) anëtare,
- Slavko Simiq (G-L S) anëtar,
- Mytaher Haskuka (G- LVV) anëtar,
- Teuta Haxhiu (AAK) anëtare,
- Valdete Bajrami (GP- Nisma) anëtare,
- Kujtim Paçaku (GP-6+) anëtar.

Teuta Haxhiu- Tha se paraprakisht ne duhet të kemi aplikacionet dhe materialet e pastaj të bëhet shqyrtimi i tyre, sepse duhet për t'i parë biografitë e secilit kandidat për ta vlerësuar se kush i plotëson kushtet.

Kryetarja- Tha se të premtën e pranojmë materialin dhe e shqyrtojmë aty në takim, neni 3 i rregullores për zgjedhjen e Avokatit të Popullit flet për procedurat, ku ceket se paneli

e shqyrton secilin aplikacion për të konstatuar nëse janë plotësuar të gjitha kushtet formale të parapara në konkurs.

Teuta Haxhiu- Kjo se çka u tha është edhe një punë që mund ta bëjë edhe administrata e komisionit, sepse për ta shqyrtuar aplikacionin e kandidatëve për një ditë duhet kohë dhe për atë është mirë me e pasur dokumentacionin së paku tri ditë përpara, por nëse veç duhet për ta parë se a i kanë të gjitha dokumentet në rregull, këtë mund ta kryejë edhe administrata, dhe se askund në rregullore nuk po mund ta gjej se është e ndaluar që deputetët të mos e kenë materialin.

Kryetarja - Tha se ka dallime ky konkurs prej konkurseve të tjera, sepse për zgjidhjen e Avokatit të Popullit ekziston rregullore e veçantë që i përcakton edhe mënyrën e punës dhe se neni 4 i kësaj rregullore flet për konfidencialitetin.

Salihe Mustafa- Tha se i kemi dokumentet bazë që përcaktojnë rregullat për zgjedhjen e Avokatit të Popullit si ligjin dhe rregulloren që duhet të bazohemi, falënderoj OSBE- në për trajnimin që do të na mbajë, po ashtu edhe nismën e të rinjve që na e ka sjellë një broshurë me praktikën e kaluar të zgjedhjes së Avokatit të Popullit.

Mexhide Mjaku- Tha se këtij paneli i uroj punë të mbarë, do të lutesha të bëni një përzgjedhje të arsyeshme dhe të zgjidhet personi që e meriton.

Kryetarja- Tha se neni 7 i rregullores na obligon që propozimet duhet t'i paraqesim në Komision dhe të miratohen prej tij, kështu që edhe ju keni mundësi me dhënë kontributin tuaj.

3. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër

Kryetarja- Tha se duhet të formohet grupi punues me së paku 3 anëtarë dhe jam munduar me i nda përgjegjësitë në mënyrë të arsyeshme, dhe propozoj Salihe Mustafen, Etem Arifi dhe Teuta Haxhiu, por mund të marrin pjesë edhe anëtarët tjerë të Komisionit.

Kryetarja konstaton se Komisioni unanimisht vendosi të nxjerrë këtë;

Përfundim

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër në këtë përbërje:

Salihe Mustafa, Etem Arifi dhe Teuta Haxhiu.

4. Të ndryshme

Mexhide Mjaku-Topalli propozoj që grupi i caktuar për shqyrtimin e Peticioneve nëse kanë kohë, pas mbledhjes të ndalen dhe të diskutojnë sa i përket shqyrtimit të peticioneve.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi